



REAGIM PUBLIK NGA QENDRA PËR DREJTËSI GJINORE

Në nisje të fushatës së 16 Ditëve kundër Dhunës me Bazë Gjinore po përballemi me efektet e dezinformimit për barazinë gjinore dhe konceptin e stereotipeve gjinore.

Tashmë dezinformimi ka dalë nga studiot televizive dhe shkon thellë në mendësinë e prindërve dhe, për pasojë, në formësimin e brezit të ri. Falë dezinformimit po bëjmë hapa galopantë pas.

Fakti se mësuesve në një shkollë 9-vjeçare, nga vetë ky institucion, iu është kërkuar të fshijnë një material mbi barazinë gjinore (pjesë e kurrikulës shkollore) të shpërndarë të prindërit tregon se sa, jo vetëm shoqëria shqiptare, por edhe institucionet po pësojnë presionin e zërave që qëllimisht keqinterpretojnë.

Barazi gjinore nënkupton të drejta, përgjegjësi, mundësi, pjesëmarrje dhe përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në të gjitha fushat e jetës. Kjo nuk lë vend për diskutim.

Barazi gjinore do të thotë se vajzat dhe gratë, *de jure* dhe *de facto*, janë të barabarta me djemtë dhe burrat.

Barazi gjinore do të thotë që gratë dhe vajzat nuk pranojnë dominancën e burrave në shoqëri, nuk janë inferiore, nuk kanë asnjë arsye për të qenë.

Barazia gjinore nuk ka asnjë lidhje me ndryshimin e gjinisë biologjike dhe nuk synon të cenojë identitetin e fëmijëve. Ajo synon vetëm të garantojë që vajzat dhe djemtë të rriten me mundësi të barabarta, pa qenë të kufizuar nga role të imponuara, paragjykime apo stereotipe që ua ngushtojnë të ardhmen.

Është e rëndësishme të nënvizohet se luftimi i stereotipeve gjinore është një detyrim ligjor, institucional dhe moral i sistemit arsimor shqiptar dhe i çdo profesionisti që punon me fëmijë.

Stereotipet gjinore janë rrënja e shumë formave të diskriminimit dhe dhunës: ato u mësojnë vajzave të jenë të nënshtruara dhe djemve të mendojnë se dominanca është e pranueshme. Kjo është e rrezikshme, e gabuar dhe krejtësisht e papranueshme.

Prandaj, çdo përpjekje për ta paraqitur barazinë gjinore si “kërcënim” është në fakt një kërcënim ndaj të drejtave dhe sigurisë së fëmijëve tanë. Ne nuk mund të lejojmë që frika, konfuzioni apo keqinformimi të kthehen në gracka për institucionet dhe komunitetin.

Në një kohë kur Shqipëria po përpiqet të ecë përpara drejt standardeve evropiane, është e trishtë të shohim se si zëra të bazuar në keqinterpretim arritën të shtyjnë prapa një nismë të thjeshtë informuese, të hartuar vetëm për të ndihmuar prindërit të rrisin fëmijë të lirë nga stereotipet.

Ne u bëjmë thirrje institucioneve arsimore të mos tërhiqen përballë presionit të dezinformimit. Po ashtu, u bëjmë thirrje prindërve të informohen nga burime të besueshme, të dialogojnë me profesionistët dhe të mbajnë në vëmendje se barazia gjinore është në interesin më të mirë të fëmijëve të tyre, të vajzave dhe të djemve.

Fushata e 16 Ditëve kundër Dhunës me Bazë Gjinore duhet të na ndërgjegjësojë se dhuna fillon me paragjykim, me stereotip, me heshtje. Prandaj sot, më shumë se kurrë, kemi detyrimin të flasim qartë, të reagojmë fort dhe të mbrojmë vlerat e barazisë dhe dinjitetit njerëzor.

Barazia gjinore është një vlerë komunitare, një standard demokratik dhe një e drejtë themelore. Ajo nuk negociohet. Ajo mbrohet.